




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.4, datë 03.10.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES “KËRKESË PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM TË UJOR PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR SIPËRFAQEN E STRUKTURES > 150 m²” SUBJEKTI “BASHKIA LUSHNJE”

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Kërkesë për autorizim për përdorim të uJOR për veprimtari ndërtimore në brigje kur përdorimi është për sipërfaqen e struktures > 150 m²” subjektit “Bashkia Lushnje”, me adresë rruga “Kongresi” Lushnje Qarku Fier. (Rehabilitim i Përroit Lushnje dhe rllkualifikimi urban i zonave rreth tij(Segmenti nga Burimi pranë varrezave publike deri te rruga Lasgush Poradeci degëzimi i rrugës Hani i Salushes)Lushnje)
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
Vendndodhja e burimit ujor - Përroi i Lushnjes
 - X=475851.447; Y=4535426.131; Z=27 m.m.n.d. (KRGJSH)
 - X=473925.047; Y=4534082.131; Z=13 m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

